

Tiranë, më datë 26.09.2022

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQERISE TREGTARE**

“Rruga PRESS” SH.P.K.

Ne baze te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ne Ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” sot ne date 20.09.2022, Unë e nënshkruara, Megi Mustafaraj, lindur në Çorovode, me datë 04.03.1995, banuese në në Çorovode adresen: Rruga e Deshmoreve ND 090, Hyrja 1, Apartamenti 15, në Çorovode 5401, Skrapar, Shqiperi, me nr personal J55304006J dhe nr karte identiteti 038250634 si me poshte vijon:

**NENI 1
EMËRTIMI**

Formohet Shoqeria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **“Rruga PRESS”** (me poshte do te quhet Shoqeria).

**NENI 2
SELIA E SHOQËRISË**

- 2.1. Selia zyrtare e Shoqerise Tregtare **“Rruga PRESS”** Shpk., ndodhet ne adresen: **Njesia Administrtrive nr 7, Rruga “Frosina Plaku”, Ndertese private nr 43, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri.**
- 2.2. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrativ i Shoqërisë mund te hape edhe seli te tjera operative, filiale, perfaqesi dhe agjenci ne te gjithe territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashte saj.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise eshte e pakufizuar.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

- 4.1. Objekti i veprimtarise ekonomike i Shoqerise është: **Media on line, lajme on line, reklamimi i hapsires komerciale on line.**
- 4.3. Kjo Shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake apo te rrise kapitalin sipas vendimeve te Asamblese se Përgjithshme.



NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

- 5.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është prej 200,000 Lekë (dy qind mijë Lekë) dhe i ndare në 1 kuotë me vlerë 200,000 leke.
- 5.2. Kapitali nënshkruhet dhe do të derdhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- 5.3. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotat respektive që kanë në Shoqëri pa miratimin me shkrim të ortakëve të tjerë. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë me miratimin e shoqërisë dhe të drejtë parblerjes në favor të shoqërisë apo ortakëve të tjerë. Brenda 30 ditësh nga oferta për blerjen e kuotave nga ortakët e tjerë, ata duhet të vendosin nëse do ta blejnë kuotën apo nëse janë dakort për transferimin apo shitjen e saj tek një i tretë sipas kërkesës së ortakut shitës.
- 5.4. Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin ose rritjen e kapitalit të Shoqërisë.

NENI 6

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 6.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos për çdo çështje për të cilat është kompetente në bazë të legjislacionit shqiptar dhe këtij Akt Themelimit e Statuti.
- 6.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij dhe të votojë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij në kuotat e Shoqërisë.
- 6.3. Secili ortak mund të caktojë një përfaqësues në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Përfaqësuesi mund të jetë një ortak tjetër ose një i tretë i autorizuar me shkrim.
- 6.4. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Ortakët ose përfaqësuesit e tyre mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike, duke përfshirë telekonferencat dhe/ose videokonferencat.
- 6.5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga çdo ortak, në bazë të nenit 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet me njoftim me shkrim, nëpërmjet telefaksit ose letrës rekomande, apo nëpërmjet postës elektronike dhe i njoftohet të gjithë ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen. Njoftimi duhet të përmbajë çështjet e ditës për diskutim, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 6.6. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e mbylljes së viti ushtrimor.
- 6.7. Për çështje të cilat vendosen me shumicë të thjeshtë votash, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të jetë e vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë, në përputhje me nenin 86, pika , të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 6.8. Asambleja e Përgjithshme, për ndryshime në Aktin e Themelimit dhe Statutit, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë,



vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje, në përputhje me nenin 87, pika , të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 7 ADMINISTRIMI

7.1. Shoqëria do të administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori caktohet në Statutin e Shoqërisë, dhe më pas emërohen, riemërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Aktualisht, Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.

7.2. Administratori gezon të drejta të plota në drejtim të administrimit të Shoqërisë dhe mund të kryejë çdo veprim që e konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve që janë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme apo të organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjes për të gjitha veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe gjithashtu mund të caktojë përfaqësues për kryerjen e veprimeve për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, caktimi i përfaqësuesit nuk e përjashton Administratorin nga përgjegjësia.

7.3. Asambleja e Përgjithshme vendos për shpërblimin e Administratorit.

7.4. Administratorët nuk mund të marrin borxhe nga Shoqëria apo të japin garanci në emër e për llogari të Shoqërisë në lidhje me borxhe apo investime të dhëna nga palë të treta.

7.5. Administratori do të veprojë gjithmonë në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikt interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët, si dhe do të abstenojë nga përmbushja e ndonjë veprimi që lidhet me situatën e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

7.6. Administrator i shoqërisë është **Megi Mustafaraj**, lindur në Çorovode, me datë **04.03.1995**, banuese në adresen: Rruga e Deshmoreve ND 090, Hyrja 1, Apartamenti 15, në Çorovode 5401, Skrapar, Shqipëri me **nr personal J55304006J** dhe nr karte identiteti **038250634**, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

NENI 8 VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të cdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 9 KONTROLLI FINANCIAR

Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Eksperti Kontabël i Regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë Ekspert Kontabël të Regjistruar.

NENI 10
BILANCI VJETOR

Bilanci vjetor, raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga eksperti Kontabël i Regjistruar i nenshtrohen miratimit te Asamblese së Përgjithshme brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 11
DIVIDENTI

Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

NENI 12
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë, administratorit, likuidatorit, Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 13
HARTIMI I AKTIT

Ky Akt themelimi dhe Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën italiane dhe në 2 (dy) kopje në gjuhën shqip.

NENI 14
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi. Persa nuk eshte shprehur ne kete Statut, do të zbatohet ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

“Rruga PRESS” SHPK

MEGI MUSTAFARAJ

Megi Mustafaraj

Tirane, me date 26.09.2022

M. Mustafaraj